1. Autoriteti/Enti Kontraktor përcakton ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kriterëve të përcaktimit të ofertës fituese që janë përcaktuar në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit si më poshtë.

Opsioni 1) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, bazuar në kosto:

Lidhur me kriteret e vlerësimit, duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter, përkatësisht numri i pikëve për secilin kriter dhe mënyra se si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave janë objektive dhe shprehen në shifra. Në çdo rast, kur ka më shumë se një kriter, pesha specifike e kriterit të çmimit nuk duhet të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që mund të marrë një Ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën llogariten pikët e ofertuesve, në çdo rast duhet të jetë:

$$P_o = P_{k1} + P_{k2} + P_{k3} + \dots$$

Ku:

P_o - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

$P_{k1}/P_{k2}/P_{k3}/\dots$ - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar

Pikët për secilin kriter llogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{mink1} \times P_{maxk1}/O_{k1}$$

P_{k1} _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{mink1} _____ Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

P_{maxk1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHENIM: Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

22. Vlerësimi i ofertave dhe korigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta

3. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kritere vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korigjon këto gabimesi më poshtë:

- (a) Nëse ka një mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit për njësi me sasinë, çmimi për njësi do të mbizotërojë dhe çmimi total do të ndryshohet përkatësisht.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje në çmimin total, kur totali është shuma ose diferenca e nën-totaleve, çmimi nën-total mbizotëron dhe çmimi total korigjohet bazuar në të.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis fjalëve dhe numrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë. Përrjashtim nga ky rregull është situata kur shuma ka të bëjë me gabimin, i cili do të korigjohet sipas pikave (a) dhe (b) më lart, prandaj në këtë rast shuma në numër mbizotëron dhe ajo me fjalë do të korigjohet.
- (d) Nëse ekziston një mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë, përveç nëse shuma e shprehur me fjalë lidhet me një gabim aritmetik, rast në të cilin shuma në shifra do të mbizotërojë në bazë të (a) dhe (b) më sipër.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- vlera absolute e të gjitha korigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- vlera absolute e të gjitha korigjimeve është më pak se 2%, por korigjimi nuk pranohet nga ofertuesi.

2. Kur autoritetet /entet kontraktore vërejnë se oferta është anomalisht e ulët, i kërkojnë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni.

- Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.
- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin / elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 te LPP dhe nenin 75 te VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 1/1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca 7. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9 : Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 10 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Shtojca 11- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 12 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 1/1.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët]

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimin dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlere absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	6	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	

1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkreisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

SPECIFIKIME TEKNIKE per procedurën: “Furnizim me paisje dhe aparatura mjekësore për SUT e ndarë në lote” e ndare ne 12 lote, si me poshte:

Loti 1- Furnizim/vendosje për pajisje mjekësore të Shërbimit të Neurokirurgjisë:

Nr	Emertimi	Sasia
1	Sistem i lëvizshëm me rreze X, për aplikime neurokirurgjikale	1
2	Sistem Neuroendoskopie kraniale dhe spinale	1
3	Krevat spitalor për pacientet ne shërbimin e neurokirurgjisë	20

SPECIFIKIME TEKNIKE

1. Sistem i lëvizshëm me rreze X, për aplikime neurokirurgjikale:

Sistem imazherie shumëdimensional kirurgjikal, i lëvizshëm për përdorim në procedurat spinale, ortopedike, kraniale.

Sistemi te përbehet nga dy pjesë te lëvizshme: Sistemi i përfutimit te imazhit dhe Stacioni mobile i shikimit.

Sistemi përfutimit te imazhit duhet te ketë sistem transporti te motorizuar me bateri që lejon lëvizjen dhe përdorimin në salla operacioni të ndryshme.

- Stacion vrojtimi i lëvizshëm ne karroce me monitor dixhital, jo me te vogël se 30".
- Sistemi te ketë Fluoroscopi ne 2D dhe skanim te shpejtë te imazhit ne 3D ne jo me shume se 13 sekonda.
- Sistemi te suportoje imazh volumetrik tre-dimensional me shfaqje të shpejtë ne ekran te rindertimit tre-dimensional me tre pamje ortogonale.
- Sistemi te jete i pajisur me mouse wireless dhe steril.
- Unaza e mbyllur ne forme "O" te mund te hapet ne forme "C" per nje aksesim me te lehte te pacientit, si dhe te mundësojë aksesim lateral te pacientit.
- Unaza e mbyllur ne forme "O" te mundesoje flouroskopi dy-dimensionale.
- Unaza e mbyllur ne forme "O" te mundesoje imazh ne 3D.
- Unaza te ketë mbulesa sterile për imazh intra-operativ ne mjediset sterile.
- Sistemi i pozicionimit te gantry duhet te jete plotësisht i motorizuar dhe me funksion memorizimi.

- Lëvizjet e motorizuar te gantry duhet te jene paktën: lart- poshtë, majtas-djathtas, para- mbrapa, tilt, lekundese izolekundese.
- Memoria te jete e programueshme dhe te mund te programohen deri ne 4 pozicione te gantry ne lidhje me pacientin.
- Unaza e mbyllur rrethore te mundësojë një imazh te plote prej 360 gradësh.
- Duhet te ketë një përfitim imazhi te paktën 30 fps
- Te regjistroje deri ne 390 imazhe me definicion standard ne 360 grade ne me pak se 15 sekonda.
- Te mund te regjistroje deri ne 760 imazhe ne 360 grade ne me pak se 30 sekonda. Imazhet te jene tre-dimensionale me definicion te larte.
- Te ketë drite lazer orientuese për te udhëzuar pozicionimin e pacientit brenda unazës.
- Te realizoje ndërthurjen jo me pak se 9 imazheve ne 2D, ne një imazh te vetëm.
- Te realizoje rindërtimin multiplanar ne mënyrën e punimit 3-dimensional.
- Gjeneratori i sistemit te ketë një fuqi maksimale jo me te vogël se 32 kW.
- Detektori me rreze X te jete me panel te sheshte jo me te vogël se 2048x1536.
- Te mund te transferoje te dhënat ne formatin DICOM
- Te mund te realizohet rruajtja e te dhënave ne CD ose USB flash drive
- Te ketë ndërfaqe për lidhjen me neuronavigatorin StealthStation
- Te ketë teknika skanimi për paciente ose për zona anatomike te vështira për tu skanuar.
- Te lejoje shikimet e drejtuara ortogonalisht përgjatë trajektoreve te dëshiruara.
- Te ketë rrotullim izo-centrik ne lidhje me imazhin lateral, te paktën ne diapazonin +/- 12°, ne mënyrën e punimit flouroskopike.
- Te mundësojë kolimimin vellimor 3D kranial/spinal
- Te jete i përfshirë printer
- Te ketë teknike skanimi te optimizuar për imazhin kranial.
- Te realizoje transferimin automatik tek sistemi i navigimit kur kryhet 3D
- Te realizoje regjistrimin automatik te pacientit kur përdoret me sistemin e navigimit.
- Te ketë shume fusha shikimi
- Te ketë software dhe protokoll dozimi per te optimizuar imazhin e lokalizuesve ne procedurat me kornize stereotaksi.
- Te shoqërohet me modulet dhe software e duhur për lidhjen me neuronavigatorin StealthStation
- Te përfshihen modulet dhe përditësimet/ përmirësimet e nevojshme te neuronavigatorit Stealthstation për tu lidhur sistemin e ofruar

Sasia: Cope 1

2. Sistem Neuroendoskopie kraniale dhe spinale

Neuroendoskop

Sistemi videoprocesor

- Njesia e videoprocesimit Full HD (1920x1080 pixel)
- Pajisur me teknika për përmirësimin e imazhit
- Funksion për reduktim te tymit
- Funksion për reduktim te zhurmës
- Rregullim automatik te ndriçimit
- Konstrast dinamik
- Përmirësim te ngjyrës se kuqe.
- Me kontroll te ndriçimit
- Mundësi zmadhimi te imazhit dixhital te paktën 1.5 here
- Te ketë kontroll te burimit te dritës nga kamera
- Shfaqje e parametrave ne ekran (on screen display)

-
- Vizualizim imazhi 4K ne kombinim me ekranin 4K
 - Dalje video te paktën: HD-SDI; 3G-SDI; DVI-D
 - Klasifikimi CF defibrillation safe

Kamera endoskopike

- Te jete kamera me sensor 3CMOS
- Kompatibel me sistemin video te ofruar me sipër
- E afte për marrje imazhesh progresive ne formatin Full HD 1920x 1080piksel
- Skanim progresiv 60Hz
- Me fokus te rregullueshem 15-27mm
- Te ketë zmadhim optik jo me pak se 2x
- Te ketë zmadhim digital jo me pak se 1.5x
- Me 4 butona lehtësisht te programueshem te paktën 8 funksione
- Gjatësia e kabllit te paktën 390 cm
- Mbajtëse kamere me te paktën 3 nyje fleksibel

Monitor mjekësor, 4K

- Kompatibel me video-procesorin e imazhit
- Teknologjia TFT-LCD
- Madhësia e ekranit te paktën 31"
- Rezolucioni te paktën 3840x2160 pixel
- Raporti 16:9
- Ndryçimi maksimal te paktën 350 cd/m²
- Kontrasti te paktën 1500:1
- Këndi i shikimit te paktën 175° H / 175° V
- Te ketë hyrje video: 4x BNC (3G SDI); display port; 2x DVI-D
- Te ketë dalje video: 4x BNC (3G SDI); DVI-D
- Furnizuar me bazament/mbajtëse për karrocën e endoskopise

Burimi i dritës LED

- I përshtatshëm për ndërhyrje endoskopike etj
- Teknologji LED me jetëgjatësi te paktën 30,000 ore pune
- Me matës te integruar te dritës ne dalje
- Te ketë ekran LCD te integruar jo me te vogël se 2 inc, për te treguar parametrat e burimit te dritës
- Temperatura e ngjyrës jo me pak se 5660K
- Fluksi i dritës jo me pak se 2500 lumen
- Kontroll manual dhe automatik i ndriçimit
- Rregullim i vazhdueshëm i intensitetit te dritës.
- Mundësi komunikimi/komandimi nga kamera
- Te ketë sistem mbrojtje kundra shkëlqimit verbues
- Klasifikimi CF defibrillation safe
- Ushqimi me energji elektrike: 100-240V AC, 5/600 Hz

Kabli i dritës me fibra optike

- I përshtatshëm për lidhjen e endoskopeve me burimin e dritës
- Diametri jo me shume se 5mm
- Gjatësia te paktën 350 cm

Sistem video Dokumentimi

- Regjistrim i videove dhe imazheve

-
- Te ketë mundësi lidhje ne network
 - Kompatibel me standardin DICOM 3.0
 - Mundësi ruajtje ne DVD, USB, HDD, LAN ose PACS server
 - Mundësi ruajtje automatike e backup ne HDD te brendshëm
 - Te ketë formate e imazheve JPEG, Bitmap, PNG, dhe video Mpeg-2 dhe MPEG-4 (AVC/H264)
 - Te ketë sistem operativ Windows
 - Te ketë software shikimi kompatibel me windows dhe Apple OS
 - Mundësi komandimi nëpërmjet kamerës, mousit, tastierës, ekranit touchscreen
 - Te ketë raporte te printueshme
 - Mundësi eksportim ne PDF te raporteve
 - Te ketë hyrje: 3G-SDI, HD-SDI
 - Te ketë dalje DVD-D dhe Display port
 - Te ketë jo me pak se 8 dalje USB dhe porte Ethernet
 - Te ketë remote control

Karroce endoskopike

- E përshtatshme për pozicionimin e pajisjeve te endoskopise dhe kamerës
- E lëvizshme, me rrota te kthyeshme me frena
- Te jete me konstrukcion modular
- Me 4 plane për vendosjen e pajisjeve dhe një sirtar me çelës
- Pajisur me furnizues energjie për pajisjet e ofruara
- Dimensionet e përafërta: 70 x 65 x 150 cm (+/-10%)
- Te ketë transformator izolimi te integruar

Seti i endoskopeve dhe instrumentave intraventricular

- Trokar intraventricular me 1 kanal, gjatësi 150mm diametër jo me te madh se 3.2mm, kanali i endoskopit jo me te vogël se 2.8mm – 1 cope
- Trokar intraventricular me 3 kanale, gjatësi 150mm diametër jo me te madh se 4.6mm, kanali i endoskopit jo me te vogël se 2.8mm, 2 kanale irrigimi/aspirimi– 1 cope
- Trokar intraventricular me 4 kanale, gjatësi 150mm dimeter jo me te madh se 6mm, kanali i endoskopit jo me te vogël se 2.8mm, kanali punës jo me i vogël se 2.2mm, 2 kanale irrigimi/aspirimi– 1 cope
- Endoskop intraventricular 0°, gjatësia 180mm, me diametër jo me te madh se 2.7mm – 1 cope
- Endoskop intraventricular 30°, gjatësia 180mm, me diametër jo me te madh se 2.7mm – 1 cope
- Mikro gërshërë me gjatësi jo me pak se 265mm, te mprehta – 1 cope
- Mikro gërshërë me gjatësi jo me pak se 265mm, te pa maje – 1 cope
- Pince biopsie me gjatësie jo me pak se 265mm – 1 cope
- Pince fiksimi dhe disektimi me gjatuesi jo me pak se 265mm – 1 cope
- Pince mikro kirurgjikale me gjatësi jo me pak se 265mm -1 cope
- Elektrode bipolare ne forme piruni me gjatësi pune jo me pak se 255mm -1 cope
- Elektrode monopolare me gjatësi jo me pak se 255mm – 1 cope
- Elektode monopolare ne forme grepi 90° - 1 cope
- Elektrode monopolare gjilpëre – 1 cope
- Elektode monopolare ne forme grepi 45° - 1 cope
- Elektode monopolare ne forme grepi 180° - 1 cope
- Kabell elektrobisturie per elektodat monopolare – 1 cope
- Kabell elektrobisturie për elektodat bipolare -1 cope
- Gershere fleksibel me gjatësi jo me pak se 250mm - 1 cope
- Pinca kaspe fleksibel me gjatësi jo me pak se 250mm - 1 cope

- Pinca biopsie fleksibel me gjatësi jo me pak se 250mm - 1 cope
- Introducer 19Fr - 1 cope
- Kanjule aspirimi me diametër jo me shume se 2mm, 0° - 1 cope
- Kanjule aspirimi me diametër jo me shume se 2mm, 45° - 1 cope
- Krah mbajtës me 3 nyje, përfshire mbajtësen e endoskopit 3-7mm dhe mekanizmin montues ne tavoline operacioni – 1 cope
- Kontenier sterilizimi për endoskopet dhe trokaret, përfshire mbajtëset për secilin endoskop – 1 set
- Kontenier sterilizimi për instrumentat dhe elektrodën, përfshire mbajtëset për secilin instrument/ elektrode – 1 set

Seti i endoskopeve dhe instrumentave spinal

- Trokar me diametër 13MM, gjatësi 75MM - 5 cope
- Dilator shufër përmasa 10X400MM - 1 cope
- Spekulum i shkurtër 45MM -1 cope
- Spekulum i gjatë 75MM -1 cope
- Retraktor Kocher-Langenbeck 35X8MM215MM – 2 pc
- Endoskop diametric 10MM këndi 30° gjatësia 330MM -1 cope
- Fiber optike diametric 4.8MM gjatësia 350cm - 1 cope
- Gershere grep diametri 5mm gjatësia 310MM -1 cope
- Gershere Metzenbaum te mesme, diametri 5 mm, gjatësia 310mm - 1cope
- Disektor Maryland me dhembe te kryqëzuar diametri 5 mm, gjatësia 310mm – 1 cope
- Disektor Overholt 90° diametri 10 mm, gjatësia 310mm – 1 cope
- Pince Heywood-Smith diametri 10 mm, gjatësia 310mm – 1 cope
- Pince kapse Nelson, 6x7 dhembe diametri 5 mm, gjatësia 310mm – 1 cope
- Sonde eksploruese diametri 10 mm, gjatësia 400mm – 1 cope
- Grep eksplorues diametri 5mm – 1 cope
- Doreze për elektrode monopolare 5mm – 1 cope
- Electrode ceramike me maje J – 1 cope
- Kabell elektrobisturie monopolare gjatësi 3.5m – 1 cope
- Portage e harkuar diametric 5mm, gjatësia 310mm -1 cope
- Aplikator klipash me vetembushje diametric 10mm gjatësia 370mm – 1 cope
- Klipe me ligimi M/L – kuti me 12 cope
- Shtytes nyjesh diametric 5mm, gjatësia 310mm – 1 cope
- Bisturi endoscoike rrethore diametric 5 mm – 1 cope
- Ronger i drejte 4mm gjatësia 320mm -1 cope
- Ronger i drejte 6mm gjatësia 320mm -1 cope
- Ronger i harkuar lart 4mm gjatësia 320mm -1 cope
- Ronger i harkuar lart 8mm gjatësia 320mm -1 cope
- Ronger Kerrison 4mm, 90° lart, gjatësia 310mm -1 cope
- Ronger Kerrison 2.5mm, 130° lart, gjatësia 310mm -1 cope
- Endo disektor 10mm – 1 cope
- Disektor kocke 4.5mm me kënd – 1 cope
- Kyrete endo e drejte 4.4x6.2x80mm gjatësia 310mm -1 cope
- Kyrete endo e drejte 5.2x7.3x80mm gjatësia 310mm -1 cope
- Kyrete endo e harkuar 4.4x6.2x80mm gjatësia 310mm -1 cope
- Kyrete endo e harkuar 5.2x7.3x80mm gjatësia 310mm -1 cope
- Kyrete drejtkendore 7x5mm gjatësia 310mm -1 cope
- Kyrete unaze diameter 6.4mm gjatësia 310mm -1 cope
- Çekiç me çarje - 1 cope
- Osteotome endo 8mm, këndi 10°, gjatësia e punës 80mm- 1 cope

- Osteotome endo 8mm, e drejte, gjatësia e punës 80mm- 1 cope
- Raspator gjerësia 8mm - 1 cope
- Resektor me kënd 120°- 1 cope
- Mbajtës grafiti gjatësia 330mm – 1 cope
- Instrument matës per graft kocke -1 cope
- Impaktor endo, I drejte gjatësia e punës 80mm, gjatësia totale 310mm -1 cope
- Kutitë mbajtëse endoskopi per sterilizim- 1 cope
- Kontenier sterilizimi I përberë nga 2 kosha mbajtës instrumentash, kontenieri, kapaku– 2 set
- Shtrese silikonit me përmasa DIN -2 cope

Sasia: Cope 1

3. Krevat spitalor për pacientet në shërbimin e neurokirurgjisë

- Shtrati duhet të ketë 4 motorë. Të jetë në gjendje të ofrojë lëvizje të rregullimit të ekzaminimit auto-kontural kardial vaskular pranë shtratit, këmbës, lartësisë dhe trendelenburgut.
- Pjesët metalike të shtratit duhet të jenë të veshura me material elektrostatik.
- Shtrati duhet të ketë tokëzim antistatik dhe pjesë ekuipotenciale për sigurinë e pacientit.
- Panelet anësore të përbërë duke përdorur lëndën e parë PP dhe teknologjinë e derdhjes me fryrje.
- Për të siguruar lartësinë dhe lëvizjet trendelenburg të shtratit, duhet të ketë sisteme rrëshqitëse të integruara në nënkornizë në një kënd 9° (+-1).
- Paneli i kontrollit të jashtëm të infermierit duhet të ketë 15 funksione (butona) ku të përfshihen: auto-kontur, kardiake, lartësia, trendelenburg 16°, reverse trendelenburg 16°, CPR elektronike, ndriçimi poshtë shtratit, treguesi ndezjes/fikjes
- Me tregues anësore të këndit për mbështetësen
- Paneli i kontrollit të brendshëm të pacientit duhet të ketë 9 funksione (butona) ku të përfshihen: rregullimi i mbështetëses së këmbës, auto-kontur, pozicioni i evakuimit të pacientit, rregullimi i lartësisë
- Shtrati duhet të jetë me bateri për të mundësuar lëvizjen gjatë transportit dhe duhet të jetë në gjendje të japë një sinjal zanor kur ngarkesa e baterisë është e ulët.
- Pjesa e pasme e krevatit duhet të kthehet automatikisht (regression)14.5cm.
- Pjesa e gjurit e krevatit duhet të kthehet automatikisht (regression)10.5cm.
- Duhet të jetë i pajisur me mbrojtëse kundër goditjeve në 4 cepat e pjesëve të kokës dhe këmbës së shtratit.

Specifikimet Teknike:

- Përmasat e krevatit duhet të jenë afërsisht: 99.5x220 + - 2 cm.
- Rregullimi i lartësisë së krevatit në mënyrë duhet të jetë: min 40 + - 2 cm dhe max 82 cm + - 2 (pa përfshirë dyshekun).
- Lartësia e panele anësore nga platforma e dyshekut të jetë afërsisht 38 cm.
- Platforma e dyshekut me përmasa afërsisht: 85x195cm.
- Lartësia e dyshekut 20 cm deri 25 cm
- Mbulesa e dyshekut duhet të lahet në maksimum 85°C.
- Kapaciteti mbajtës jo më pak se: 250 kg.
- Me funksion të zgjatjes së shtratit të paktën 20 cm
- Me sistem peshimi të pacientit dhe ruajtje të dhënash. Duhet të jetë i kalibrueshëm nga 4 skaje me kapacitet peshimi të paktën 1 kg dhe 250 kg dhe ndjeshmëri 0.1 kg.
- Shtrati duhet të ketë një sistem kyçje qendrore me 3 mënyra.
- 4 rrota të lëvizshme me diametër prej 150 mm.

- Duhet të ketë një mbajtës për kasetat e grafisë, me gjatësi të seksionit të rrëshqitjes për mbajtësen e kasetës duhet të jetë së paku 52 cm.
- CPR manuale. Duhet të ketë gjithsej 2 krahë CPR manuale në anën e djathtë dhe të majtë të shtratit.
- Duhet të ketë gjithsej 4 fole për mbajtëse serumi dhe stativ IV prej celiku.

Sasia: Cope 20

Pajisjet mjekësore të kërkuara më sipër duhet të plotësojnë detyrimisht këto kushte:

-Garanci: Jo më pak se 1 (Një) Vit duke filluar nga data e vendosjes ne funksion të pajisjes.

-Pajisjet mjekësore të jenë sipas standardeve CE ose FDA,

-Afati i furnizimit: Brenda tre muajve ose nëntëdhjetë ditë duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës se furnizimit.

-Afati i vendosjes: Sipas kërkesave te AK

Loti 2- Furnizim/vendosje pajisje mjekësore për Sallat Operatore

Nr	Emertimi	Sasia
1	Sistem i lëvizshëm C-Arm me detektor me panel të sheshtë	3
2	Veshje plumbi për C-Arm	10

Specifikimet teknike:

1. Specifikime teknike për Sistem i levizshem C-Arm me detector me panel të sheshtë:

Sistem i levizshem C-Arm me detector me panel te sheshte

- Detektor i sheshte $\geq 25 \text{ cm} \times 25 \text{ cm}$
- Tregues lazer i integruar ne detektor i cili prodhon nje kryq
- Madhesia e pikselit $\leq 185 \mu\text{m}$ jo me i madh
- Dixhitalizimi $\geq 16 \text{ bit}$ jo me i vogel
- Matrica $\geq 1500 \times 1400$ piksel
- Grilje $f_0 = 100 \text{ cm}$
- Mundesi per tre fusha aktive
- Resolucion ne monitor gjate grafise $\geq 2,5 \text{ lp/mm}$ pa zmadhim dhe $\geq 3.0 \text{ lp/mm}$ ne te gjitha fushat e tjera aktive
- Resolucion ne monitor gjate fluoroskopise $\geq 2,5 \text{ lp/mm}$ pa zmadhim dhe $\geq 3.0 \text{ lp/mm}$ ne te gjitha fushat e tjera aktive

Tensioni ushqyes i pajisjes

- Tensioni ne hyrje me nje faze 220V

Gjeneratori i rrezeve X

- Fuqia maksimale e gjeneratorit $\leq 15 \text{ kW}$
- Generator me frekuence te larte $\geq 50 \text{ Hz}$
- Diapazoni I kV 40 kV to 120 kV ose ekuivalent
- Imazh tek mA: $\geq 35 \text{ mA}$
- Fluoroscopi pulsuese mA: $\geq 15 \text{ mA}$
- Fluoroscopi e pulsuese $\geq 15 \text{ f/s}$

Llampa e rrezeve X

- Llampe me transformator te tensionit te larte me dy fokuse

-
- Tensioni 120 kV
 - Shperndarja e nxehtesise se anodes HU/min: $\geq 40,000$
 - Kapaciteti termik i anodes HU: $\geq 70,000$ HU
 - Filtrimi i rrezeve X sipas standardit (IEC 601) ≥ 3 mm Al
 - Matje e integruar e dozesh per afishimin e prodhimit doze siperfaqe ose vlere kerma ne ajer
 - Opsion qe per cdo pacient vlere e akumuluar te ruhet ne databazen e pacienteve
 - Kolimator me kolimim pa rrezatim (plumb)

Sistemi i C-arm

- Levizje orbitale $\geq 140^\circ$
- Pjerresim $\geq (\pm 200^\circ)$
- Levizja horizontale ≥ 20 cm
- Levizja vertikale ≥ 40 cm e motorizuar

Monitor sekondar i montuar ne C-ARM

- Monitor me prekje ≥ 10 inch
- Monitor me ngjyra me ndricim te larte

Afishues/ Monitore

- Monitor me ngjyra me ndricim te larte 2x19" (48 cm) ose nje monitor ≥ 40 "
- Diagonalja e ekranit ≥ 19 " (48 cm)
- Shfaqja e imazhit 1280x1024 (pixels)
- Ndricimi maksimal 650 cd/m²
- Raporti i kontrastit $\geq 700:1$
- Teknologjia e preferuar LED me ndricim te pasem
- Kendi i shikimit horizontal / vertikal $170^\circ / 170^\circ$ dhe te ketë mundësinë te beje lëvizje vertikale minimalisht 18 cm

Kareli i levizshem i monitoreve

- Mundesi per instalimin e dy monitoreve ose nje monitor ≥ 40 "
- Dalje USB per te dhenat: USB 2.0
- Lidhje LAN Gigabit
- IEEE 802.11 a/b/g/n/ac (2.4 GHz and 5GHz Band) WPA and WPA2, 802.1x (EAP-TLS-PEAP)
- Kabell fuqie ≥ 5 m

Hardware i PC

- Sistem operacional me 64 bit
- RAM ≥ 8 GB
- Karte grafike e nivelit profesional e performances se larte for sistemin e detektorit te rrezeve X
- Kapacitet ruajtes per $\geq 100,000$ imazhe ne hard disk, pavaresisht nga madhesia e matrices
- Te gjithet pacientet e ruajtur ne foldera te vecante
- Memorie HDD ≥ 1 TB

Administrimi i te dhenave te pacientit

- Mundesi (HIS/RIS) per marrjen e te dhenave te ekzaminimeve nga Spitali/radiologjia
- Regjistrim i pacientit te emergjences
- Administrim i studimeve dhe i te dhenave te imazhit
- Regjistrim i imazheve me filtrim dixhital
- Programe te dedikuara me doze te ulet
- "Filter shtese bakri ose alumini per reduktim te metejsheem te dozesh se pacientit"

Shfaqja e imazhit

- Shfaqje e imazhit 1k x 1k
- Diafragma dixhitale
- Zmadhim dixhital dhe zmadhim fiks
- Rrotullim dixhital i imazhit

- Zoom I detektorit
- LSH (Last Scene Hold)
- Invertim i imazhit horizontal dhe vertikal
- Invertim i imazhit Positiv/negativ
- Riluajtje e videove of scenes dhe funksion automatik i riluajtjes.

Perpunimi i imazhit

- Korrektim i metalit
- Filtrim për shfaqjen e imazheve me konture te theksuara
- Theksim i kontureve
- Reduktim i zhurmes
- Rregullim automatik dhe manual i kontrastit dhe ndriçimit
- Shenim R/L
- Matje te distances dhe te këndit

Programe dhe hardware te vecanta te kërkuara

- Digital Subtraction Angiography (DSA) te perfshihet
- Perfetim i imazhit ne Subtraction Angiography (SUB) dhe roadmap (ROAD)
- Teknike Roadmap per udhezim te lehte te kateterit, dilatacionit, dhe vendosjes se stenteve
- Perfetim i imazhit deri 30 f/s
- Mbivendosje grafike ne kohe reale
- Opsion i zhvendosjes se pikseleve
- Funksion i matjeve 2D: matje te kendeve dhe distancave.
- Shfaqje e ndryshimeve dinamike gjate injektimit te kontrastit
- Celes pedal per leshimin e rrezatimit
- Regjistruer CD / DVD per serite e imazheve dhe fluoroskopine ne regjistruer DVD
- DICOM Standard
- DICOM Printim

Garancia: Jo më pak se 1 (Një) Vit.

Sasia: 3 Copë

2. Specifikime teknike për Veshje plumbi për C-Arm

Përparse plumbi përberë nga:

- 1) Xhaketë plumbi, permasa L. Të dy anët e xhaketës për mbrojtje nga rrezet radioactive, shtresa e përparme mbrojtëse jo më pak se 0.50mm, shtresa e mbrapme mbrojtëse jo më pak se 0.25mm.
- 2) Fund plumbi, përmasa L. Të dy anët e fundit për mbrojtje nga rrezet radioactive, shtresa e përparme mbrojtëse jo më pak se 0.50mm, shtresa e mbrapme mbrojtëse jo më pak se 0.25mm.
- 3) Qafore plumbi për mbrojtjen nga rrezet radioactive, shtresa mbrojtëse jo më pak se 0.50mm, qaforja e përshtatëshme për përmasat 38-46, lartësia e qaforës 6 cm.

Sasia: 10 Copë

Pajisjet mjekësore të kërkuara sa më sipër duhet të plotësojnë detyrimisht këto kushte:

-Garanci: Jo më pak se 1 (Një) Vit duke filluar nga data e vendosjes ne funksion të pajisjes.

-Pajisjet mjekësore të jenë sipas standardeve CE ose FDA,

-Afati i furnizimit: Brenda dy muajve ose gjashtëdhjetë ditë duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës se furnizimit.

-Afati i vendosjes për C-Arm me detector me panel të sheshtë: Sipas kërkesave te AK

Loti 3- Furnizim me Aparat Elektrobisturie Bipolare për Sallat Operatore

Nr	Emertimi	Sasia	Nr
1	Aparat Elektrobisturie Bipolare për Sallat Operatore	copë	10
2	Aparat Elektrobisturie Bipolare te avancuar	copë	2

Specifikimet teknike:

1. Aparat Elektrobisturie Bipolare për Sallat Operatore

- Sistem Modular për opsione Monopolare dhe Bipolare
- Ekran min 3.5” me komanda me prekje
- 100-300 programe ne memorie për ndërhyrje kirurgjikale te ndryshme
- Sistemi duhet të kontrollohet nga mikro-procesori dhe të rregullojë fuqinë për të marrë efektin e dëshiruar në ind.
- Sistemi duhet të ketë min 2 dalje monopolare, 2 dalje bipolare
- Sistemi duhet te mundësojë aktivizimi njëkohësisht te dy dorezave monopolare .
- Sistemi të ketë alarme audio vizuale dhe vete testim nga gjeneratori
- Sistemi do të ketë Treguesin e Gabimit audiovizuale dhe me tekst ne ekran .
- Sistemi te punoje me instrumente laparoskopike
- Sistemi te kete mundesi per mbylljebn e venave deri ne 7 mm.
- Te kete mundesine e kontrollit si nga doreza dhe nga pedali (me kembe)

Specifikime teknike

- Frekuenca Nominale Min 300-350 kHz
- Monopolar 300-350 W
- Bipolar 300-350 W
- Mono Cut 300-350 W
- Mono Coag 220-250 W
- Bipolar Cut 300-850W
- Bipolar Coag 300-350 W
- Ushqimi 220 – 240 V ± 10 % 50 / 60 Hz

Aksesoret:

- 1x celes komandimi me kembe me dy pedale
- 1x Kabell për Pllaka neutrale me kontakt standarde lidhjeje 25 mm
- 1x (Kuti 100 cope) Pllaka neutral shumeperdorimshe me kontakt standart 25 mm
- 5x Doreza thike monopolare me dy butona për prerje Koagulim ,për përdorimin e elektrodave 2,4 mm
- 1x elektrode lancet e drejte (Knife electrode, straight, shaft). 2.4 mm
- 5x Kablla lidhjeje Bipolar
- 5x Forceps bipolare jo-ngjitëse gold te drejta të dizenuara posaçërisht me veti të veçanta termike duke siguruar një performancë optimale 195-200 mm, 6-8 mm x 1-2 mm
- 3x Forceps bipolare jo-ngjitëse gold bayonet, të dizenuara posaçërisht me veti të veçanta termike duke siguruar një performancë optimale 195-000 mm, 6-8 mm x 1-2 mm

Sasia: Cope 10

2. Elektrobisturi me bipolar te avancuar

Duhet te ketë te paktën 2 dalje për lidhjen e instrumentave monopolar; te cilat te jene me konektor qe lejon komandimin nga handpiece.

- Duhet te ketë te paktën 1 dalje për lidhjen e elektrodës së tokzimit.
- Duhet te ketë te paktën 1 dalje për lidhjen e instrumenteve bipolar.
- Duhet te ketë te paktën 1 dalje te bipolari te avancuar për lidhjen e instrumentave per ngjitjen e eneve te gjakut deri ne 7 mm, nyjeve lifatike, dhe indeve bundle.
- Duhet te kete ekran me prekje, jo me te vogel se 7 inch.
- Ekran i duhet te kete komandat e parametrave per secilen nga dajet; komandat duhet te jene te vecanta per secilen nga dajet.
- Ne ekran duhet te tregohen ne menyre vizuale te gjitha mesazhet, erroret.
- Pajisja duhet te ruaje te gjitha konfigurimet e vendosura nga perdoruesi dhe ne rast se hiqet nga energjia elektrike.
- Pajisja te ketë një memorie jo me te vogël se 4GB
- Pajisja duhet te kete tone zanore te vecanta dhe me volum te rregullueshem per: prerje, koagulim, bipolar, ngjitje te eneve te gjakut.
- Pajisja duhet qe te pershtase parametrat ne varesi te llojit te indit. Ajo duhet ti pergjigjet ndryshimeve te indit me nje frekuence jo me te vogel se 400000 here ne sekond.
- Pajisja duhet te kete monitorim te kontaktit te elektrodës së tokzimit me pacientin.
- Pajisja duhet te beje njohje te instrumentave me ane te teknologjise RFID, dhe te beje autokonfigurim te parametrave ne varesi te instrumentit te lidhur.
- Pajisja te kete funksionojme me forme vale sinusoidale me frekuence jo me te vogel se 420Khz
- Pajisja duhet te tregojë ne ekran rrymen ne instrumentin bipolar
- Te kete mundesi te punoje ne autobipolar.
- Ne monopolar duhet te beje: prerje te paster, te perzier; koagulim fulgurim, spra, te bute;
- Fuqi maksimale ne prerje jo me vogel se 300W
- Ne monopolar te kete mundesi qe te rritet/ ulet fuqia direct nga kirurgu nepermjet dorezes se monopolarit
- Duhet te kete te pakten 3 shkalle fuqie ne bipolar nga 1- 90 W
- Ngjitja e eneve te gjakut te kete nje fuqi jo me te vogel se 350W
- Burimi ushqimit: 200-250V / 50-60Hz
- Pajisja duhet te shoqërohet me aksesoret e meposhtem:
- Elektroda e tokzimit -10 cope shumeperdorimeshe
- Kablli i elektrodës së tokzimit – 1 cope
- Doreze monopolare me 3 butona komandimi (prerje, koagulim, hemostaze me prerje) dhe me komandim te energjise me te pakten 4 nivele – 5 cope
- Kabell per lidhjen e instrumentave monopolar universal – 5 cope
- Pedal komandimi monopolar – 1 cope
- Elektroda me maje Maryland, njeperdorimshe, per mbylljen e eneve te gjakut - 23 cm dhe 37 cm i gjate, maja te jete me nanoveshje – 2 cope (nje 23 cm dhe nje 37 cm)
- Kabell per forcepsin bipolar – 5 cope
- Pedal komandimi per bipolar - 1 cope
- Forceps bipolar – 5 cope
- Kablli i ushqimit – 1 cope

Sasia: Cope 2

Loti 4- Furnizim/vendosje pajisje mjekësore për shërbimin e Okulistikës

Specifikimet teknike:

Nr	Emertimi	Sasia
1	Ekografi A/ B SCAN Okulare	1
2	Green Laser	1
3	Yag Laser	1
4	OCT (Optical Coherence Tamography)	1
5	Topografi Corneale	1
6	Tonometër Aplanacioni	1

SPECIFIKIME TEKNIKE

1. Ekografi A/B SCAN Okulare për Shërbimin e Okulistikës

- Aparaturë me ultratinguj për diagnostikimin e syrit
- Me ekran me ngjyra me prekje me rezolucjon te pakten 1024 x 768 px
- Të kete mundesine qe te realizoje biometri edhe ne modalitein B ose (eko).
- Te mundesoje lidhjen me nje kompjuter te jashtem, printer me system operativ windows nepermjet wifi ose usb.
- Te jete I pajisur me pedale si dhe te mundesoje lishje me USB dhe Bluetooth mouse
- Te mundesoje dergimin dhe importimin e vidiove dhe imazheve ne formatin Dicom
- Te mundesoje perditesimin per funksionin Pakimetri

FUNKSIONI A SCAN SIPAS PARAMETRAVE TE MEPOSHTEM

E pajisur me sonde per matjen e lentes IOL me karakteristikat e me poshtme

- Frekuenca te pakten 11 Mhz
- Diametri I majes te jete minimumi 7mm
- Rezolucjoni elektronik te jete minimumi 0.03mm
- Thellesia e skanimit te jete minimumi 60 mm ose 1536 pika
- Menyrat e skanimit direkte dhe me zhytje
- Sonda te realizoje matjen nepermjet teknologjise laser
- Rregullimi I Gain 20 to 110 dB
- Koha e rregullimit te Gain 0 to 30 dB

Matjet e gjatesise aksiale te jete e rregulleshme ne drejtim te shpejtesise te kalimit te rrezes nga nje zone ne tjetren (dhoma anteriore e syrit, Vitrozi, Iol)

Me te pakten 5 menyra matje per katarakt, phakik, aphakik, PMMA, Akrilik dhe material silikoni per Pseudophakik etj

Te kete mundesi te realizoje matje ne modalitetin Manual, Automatik, Automatik+Rujatje te te dhenave

Te kete mundesi te realizoje matje automatike duke u bazuar ne minimumi 10 matje te gjatesise se syrit

Duhet te realizoje kalkulimin e lentes ne intervale 0.25D

Per nje llogaritje sa me te sakte te permbaje formulat:

Refractive: SRK-T, SRK-II, HOLLADAY, BINKHORST-II, HOFFER-Q, HAIGIS, Shammas regression, Double K/SRK-T (Dr. Aramberri's formula)

FUNKSIONI B SCAN SIPAS PARAMETRAVE TE MEPOSHTEM

E pajisur me sondë te tipit B per realizimin e Echo me parametrat e me poshtem

- Me Frekuenca te pakten 15 Mhz per te rritur me 30% rezolucjonin e imazheve
- Kendi I eksplorimit te pakten 50°
- Thellesia e eksplorimit te pakten 60mm
- Fokusi te pakten 24 mm
- Rezolucjoni aksial minimumi 115 µm
- Rezolucjoni Lateral minimumi 400 µm

- Frekuenca e marjes se imazheve (Frame Rate) mbi 16 Hz
- Niveli Gray te pakten 256
- Rregullimi I Gain 20 to 110 dB
- Koha e rregullimit te Gain 0 to 30 dB
- Te kete mundesi te ruaj video mbi 40 sec

Sasia: Cope 1

2. Green Laser per Sherbimin e Okulistikes

- Te jete laser fotokoagulator retinal I gjelber, I teknologjise se fundit
- Gjatesia e vales se funksionimit te jete 532nm, jeshile
- Te kete mundesi te percoje rrezet nepermjet Oftalmoskopit indirekt, Biomikroskopit ose sondave.
- Te jete I pajisur me Biomikroskop me 3 deri ne 5 zmadhime.
- Maksimumi I fuqise ne korne 1500 mW
- Madhesia e pikes 50-500 mikron
- Te jete I pajisur me ekran per selektimin e energjise dhe te parametrave te tjere
- Kohezgjatja e ekspozimit 10 ms deri ne te vazhduar
- Intervallet e perseritjes 0,1-0,2-0,3-0,4-0,5-0,6-0,7s
- Menytrat e goditjes jane Single, Repeat, Painting, Continues
- Duhet te kete system ftohes peltier
- Duhet te jete I pajisur me pedale multifunkionale
- Duhet te perfshije aksesore si tavoline, mbulesa lazeri etj.

Sasia: Cope 1

3. Yag Laser per per Sherbimin e Okulistikes

- Duhet te jete laser Okulistik me teknologjine YAG per kapsulotomine dhe Iridotomine
- Duhet te kete gjatesi vale te pakten deri ne 1064 nm
- Te kete energjine nga 0.3 deri ne 10 mJ per pulsim, e vazhdueshme variable
- Kohezgjatja e pulsimit jo me pak se 4 ns
- Shpejtesia e Goditjes jo me pak se 3 shkrepe per sekonde per nje shpejtesi dhe eficence trajtimi
- Modaliteti i goditjes te jete I perzgjedhshem per 1, 2 dhe 3 impulse per goditje,
- Madhesia e pikes se goditjes jo me e madhe se 8 μ m
- Këndi i konit duhet te jete te pakten 16 gradë
- Kompensimi (Posterior) duhet te jete 100 deri në 350 μ m, vazhdimisht e ndryshueshme
- Rrezja e goditjes duhet te jete e kuqe 635 nm, me intensitet te rregullueshem
- Shpejtësia e përsëritjes duhet te jete deri në 3 Hertz
- Zmadhimi duhet te jete i optimizuar për vizualizimin e përmirësuar të segmentit të përparmë
- Duhet te kete ftohje me Ajer
- Përmasat duhet te jene jo me shume se Lartesi 57 x gjeresi 75 x thellesi 44 cm,
- Duhet te perfshije aksesoret standart si tavolina, ekran te levizshem, syze sigurie, shenjë sigurie per lazer, mbulesë kunder pluhurit
- Te mundesoje perditesimin me video kamera, tonometer etc
- Aksesore
- Te jet e perfshire lente per iridectomy

Sasia: Cope 1

4. OCT (Optical Coherence Tomography) Angiografi 3 Dimensionale

OCT /ANGIOGRAFI 3-dimensionale me kamerë të integruar retinale me ngjyra 45° / 35° me rezolucion prej të paktën 5M pikselë dhe blic të bardhë.

